



RAPORT VJETOR

Drejtuar: Komitetit Drejtues në mbledhjen e tij të datës 25 Janar 2017

Periudha e Raportimit: Janar 2016 – Dhjetor 2016

Përgatitur nga: Drejtori Ekzekutiv i ShKSh



I. Vështrim i përgjithshëm

Të nderuar anëtarë të Komitetit Drejtues,

Prezantojmë sot para jush në këtë takim të radhës të Komitetit Drejtues (KD) aktivitetet dhe rezultatet e punës së kryer në një hark kohor prej 12 muajsh gjatë vitit 2016.

Në këtë periudhë të raportimit, Shoqata e Bashkive është angazhuar në organizimin e saj të brendshëm, transferimin dhe bashkimin me Shoqatën e Komunave. Ka vijuar normalisht funksionimi i veprimtarisë së përditshme të Shoqatës, përfshirë këtu takime të Forumeve Profesionale, komunikimi me anëtarësinë dhe bashkëpunimi me aktorë të tjerë në realizimin e aktiviteteve të ndryshme.

Ndër zhvillimet për tu theksuar të kësaj periudhe, përmendim rolin oponent dhe unifikimin e zërit dhe interesave tuaja ndaj qeverisë qendrore duke i prezantuar ato për publikun. Si dhe është parashikuar në Planin e Punës, ne kemi planifikuar disa aktivitete të cilat kanë kërkuar dhe kërkojnë domosdoshmërisht përfshirjen tuaj aktive. Përmendim shkurtimisht Takimet Rajonale në qarqe të ndryshme për strukturën organike të bashkive post reformë, takimet për ligjin e ri të financave vendore, komunikimin me mediat, si dhe deklaratat e qëndrimet e Shoqatës për çështjet e ngritura dhe që kanë shqetësuar dinamikën e pushtetit vendor.

II. Aktivitete të realizuara

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë në bashkëpunim me Fondacionin Hanns Siedel organizoi trajnim një-ditor në tre qarqe Fier, Pogradec dhe Lezhë, me qëllim ofrimin e asistencës për bashkitë në hartimin e strukturave të tyre organizative në funksion të reformave të rëndësishme, si ajo administrativo-territoriale dhe me miratimin e Ligjit 139/2015 "Për vet-qeverisjen vendore". Këto ndryshime kërkonin midis të tjerave një riorganizim të brendshëm të bashkive duke pasur parasysh dhe organizimin e funksionimit të njësive administrative si nën-ndarje të bashkive të reja. Qëllimi i këtij trajnimi është t'ju vijë në ndihmë bashkive për tu njohur më mirë me procesin e përgatitjes së strukturave organizative efikase në përputhje me legjislacionin në fuqi. Pjesëmarrës ishin Zv/Kryetarë të Bashkive, Drejtorë të Burimeve Njerëzore, Juristë dhe Administratorë, në total 80 pjesëmarrës.

Shoqata e Bashkive së bashku me bashkinë e Vaut të Dejës hartuan vet-vlerësimin financiar bashkiak. Përgatitja e tij, shoqëruar me dokumentin përfundimtar ishte si pjesë e programit të Bankës Botërore për vendet e Ballkanit dhe në bashkëpunim me NALAS janë kryer gjatë këtyre muajve një sërë përgatitjesh për vet-vlerësimin financiar të bashkisë Vau i Dejës. Ky mjet, i aplikuar dhe në vende të tjera të rajonit, synon të japë një pasqyrë financiare të qartë të bashkisë dhe të adresojë mënyra të përmirësimit të menaxhimit financiar bashkiak.



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë dhe bashkitë janë pjesë e nismës së re të Qeverisë Gjermane - "Partneritetet Bashkiake për Qëndrueshmërinë" në Evropën Juglindore. Nga kjo nisëm bashkia Shkodër, Kamëz dhe Pogradec, do përfitojnë nga partneriteti me bashkitë gjermane. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të mbështesë komunitetet lokale nga Evropa Juglindore dhe Gjermania dhe të kontribuojë pozitivisht në arritjen e "Axhendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm" (SDGs).

Katër specialistë nga Bashkive Shqiptare morrën pjesë në trajnimin e organizuar nga Unioni i Bashkive Botërore Turke (TDBB) në bashkëpunim me TIKa, mbështetur nga Bashkia Denizli dhe Kocaeli Metropolitane me 16 deri 22 Tetor 2016 bashkë me pjesëmarrjen e 16 ekspertëve të qeverisjes vendore nga 7 vende të ndryshme, "Menaxhimi i ujit, ujërave të zeza dhe sistemet e ujësjellësave në pushtetin vendor. Ernest Ymeri (Inspektori i projektit Koordinimit nga Bashkia e Skraparit, Gentjan Lami (IT Ekspert nga Bashkia e Bulqizës, Ana Shurdha (Arkitekt nga Vau Bashkia Dejës), Erion Vata (Arkitekt nga Bashkisë Kamëz).

Po kështu me ftesë të Unionit të Bashkive Turke, Shoqata e Bashkive të Shqipërisë ishte për një vizitë dy ditore në Stamboll. Bashkitë nga Shqipëria: Lezha, Kamza, Durrësi, Mallakstra, Vora, Selenica dhe Kukësi ishin pjesë e delegacionit dhe biseduan për mundësi bashkëpunimi dhe partneriteti me bashkitë turke por dhe me bashki të tjera jashtë Turqisë që janë në rrjetin e bashkive turke kudo në botë.

Bashkë me kolegët nga Bashkia Kamëz dhe Lezhë morrëm pjesë në Konferencën Ndërkombëtare "Emigracioni dhe dialogu ndërkulturor-nga global në lokal. Kjo konferencë u organizua në kuadër të projektit URGENT (Rigjenerimi Urban – Rrjeti European i Qyteteve). Shoqata e Bashkive është partnere në këtë projekt.

Këshillim për organizimin e brendshëm të bashkisë për të siguruar shërbim më të mirë për qytetarët. Kjo është tema e programit të këshillimit ofruar për Shoqatën e Bashkive dhe dy bashkitë e përzgjedhura - Bashkia Mallakaster e përfaqësuar nga Zëvendës Kryetari z. Hajredin Serjani dhe Bashkia Vau Dejës përfaqësuar me z. Herion Jashari Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë. Ky program këshillimi (Mentoring) ofrohet nga programi **BACID**, dhe **KDZ** (Qendra Kërkimore e Administratës Publike) nga Shoqata e Bashkive dhe e Qyteteve të Austrisë. Qëllimi jonë është të shohim dhe të këshillohemi mbi modele organizimi që ofrojnë shërbime të mira, modele që përfshijnë qytetarët kudo ku ato jetojnë, goftë në zona urbane apo rurale, modele me të cilat operojnë bashki të Austrisë dhe ti përshtasim sa mundemi në bashkitë tona. Dhe kjo në kontekstin e sfidave dhe vështirësive të para dhe të evidentuara në bashkitë shqiptare gjatë implementimit të reformës territoriale.

Menaxhimi i mbetjeve, gjetja e modeleve dhe praktikave efikase është dhe mbetet problem dhe sfidë për të gjitha bashkitë. Bashkia Shkodër, Lezhë dhe Vau Dejës që kanë qenë



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

përfituese nga projekti rajonal për menaxhimin e integruar të mbetjeve në zonat rurale dhe bregdetare, duhet të ndanin rezultatet dhe praktikën me bashkitë tjera. Këtij qëllimi i sherbeu pjesëmarrja në konferencën rajonale ku propozuan idetë e tyre projekt për të ardhmen. Shtatëmbëdhjetë ide janë prezantuar nga të cilat tre nga bashkitë Shqiptare (Kamza, Lezha dhe Vau Dejës) dhe në shpresojmë që shumë prej tyre do të zbatohen në periudhën e ardhshme. Si rezultat i bashkëpunimit të suksesshëm në kuadër të projektit, si dhe duke kërkuar një të ardhme me interes të përbashkët në Rajon, dymbëdhjetë Bashki të përfshira në projektin " Përmirësimi i Menaxhimit të Mbeturave të Ngurta në rurale dhe zonat bregdetare " nënshkruar memorandume bashkëpunimi për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Takime Rajonale për Menaxhimin e Mbetjeve në Zonat Rurale dhe Bregdetare të Evropës Juglindore. Rekomandime për politika rajonale. Përfaqesues të Bashkive Klos, Burrel, Lezhë, Vau i Dejës dhe Shkodër si dhe përfaqesues nga sektori i shoqërisë civile, Instituti për Kërkime Urbane ishin pjesëmarrës në Seminarin e Përbashkët i mbajtur në datat 5-6 Prill në Neum, Bosnjë dhe Hercegovinë. Ky seminar është organizuar nga NALAS dhe SWG i bërë i mundur nga GIZ dhe Bashkëpunimi Zvicerian për Zhvillim në lidhje me Zhvillimin e Masave dhe Rekomandimeve për Politika Rajonale.

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë në bashkëpunim me Fondacionin Gjerman Konrad-Adenauer-Stiftung zyra Tirane organizuan një seminar dy ditor me dt 16-17 nëntor, me qëllim marrjen e mendimeve nga specialistët e bashkive lidhur me ligjin e ri të financave vendore që është në proces hartimi. Qëllimi i këtij ëorkshopi ishte për tu njohur më mirë nga financierët/et e bashkive dhe të zgjedhurit, me strukturën dhe elementet e ri të draft ligjit, dhe krijimi i mundësive të shprehën në tryezë dhe më pas të formulojnë komentet dhe të mbrojnë mendimet e tyre teknike, pra të jenë pjesë në këtë proces hartimi dhe në procesin e përgatitjes së strukturës dhe teknikës së këtij ligji në përputhje dhe harmoni me ligjet tjera, legjislativonin në fuqi, dhe me zbatimin sa më praktik të ligjit në bashki. Pjesëmarrës në këtë seminar ishin zv/Kryetar Bashkish, Drejtues të Financave dhe Juristë nga bashkitë (rreth 30 persona).

Shoqata e Bashkive ka reaguar ndaj çështjeve me interes për pushtetin vendore kryesisht në mbrojtje të interesave tuaja dhe në përgjigje të iniciativave të qeverisë. Më poshtë po përmend disa prej tyre. Shoqata e Bashkive të Shqipërisë ka qenë kundër miratimit të ligjit për importin e mbetjeve nga jashtë, dhe e vlerëson tërësisht të gabuar qasjen, argumentat dhe llogjikën për të miratuar një ligj të tillë. Shoqata e Bashkive shpreh keqardhjen e madhe që për interesa politike dhe biznesi, të krijohet alibi se ky ligj duhet pasi nuk performojnë mirë bashkitë.

Më tej kemi adresuar çështje që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin efikas dhe në kohë të reformës administrative dhe legjislativonit të miratuar në kuadër të saj. Vazhdon të ketë jo



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

vetëm pengesa dhe vonesa të zbatimit të legjislacionit por dhe mungesa të akteve nënligjore që do të plotësonin kuadrin e plotë të reformës. Më konkretisht, nga transferimi i punonjësve të **arsimit parashkollor** (kopshtet e fëmijëve), edukatorë dhe punonjës në Qendrat Kulturore të Fëmijëve, shërbimeve mbështetëse në arsimin bazë, arsimin 9-vjeçar problem mbetet mungesa e fondeve të plota për pagat dhe sigurimet shoqërore për personelin e transferuar, fonde të pa akorduara akoma. Nuk ka patur asnjë akt normativ apo ligjor për **administrimin e pyjeve**. Kjo ka sjellë problematika përse i përket ushtrimit të funksioneve të kontrollit, vrojtimit dhe menaxhimit të pyjeve për nevoja tek të gjitha Bashkitë. Janë transferuar fondet minimale për **rrugët rurale**. Këto fonde janë tërësisht të pa mjaftueshme për mirëmbajtjen e rrjetit rrugor rural. Gjendja e rrugëve është mjaft e keqe dhe fondet minimale, shpesh as sa një e treta e fondeve që përfitonin këto territore, sot nuk janë në dispozicion të Bashkive. Procesi i transferimit të **ujësjellësve** akoma nuk ka përfunduar. Në shumë Bashki ky proces edhe pas një viti është gjysmak, i pa përfunduar, i pa koordinuar, i pa kontrolluar. Duke qenë i tillë ka sjellë problematika të mosfurnizimit me ujë të pijshëm, keqpërdorim të aseteve publike, vjedhje apo zëvendesim arbitrar dhe të pa kontrolluar.

Qëndrimi dhe shqetësimi i Shoqatës së Bashkive lidhur me **ndarjen e fondeve nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve** ka qenë kundër diskriminimit të bashkive të djathta të cilat kanë përfitur minimalisht nga ky fond. Totali tjetër i financimit ka shkuar i gjithi për bashkitë socialiste që kanë përfitur mbi 90% të totalit për financim nga FZHR. Këto financime nuk sigurojnë balancim dhe harmonizim të drejtë të shpërndarjes së investimeve rajonale dhe mbarëkombëtare. Kështu Qarqet Shkodër, Lezhë dhe Kukës janë qarqet që përfitojnë më pak se çdo qark tjetër investime.

Është për tu vlerësuar përfshirja e shoqatave të të zgjedhurve vendorë me përfaqësues në **Këshillin Konsultativ**. Rekomandimi ynë është se të zgjedhurit vendorë duhet të jenë në shumicë në numra të anëtarëve dhe kryesimi i Këshillit duhet të bëhet nga të zgjedhurit vendorë. Mendojmë se është një mundësi e humbur fakti që Këshilli jep opinione jo detyruese.

Vështirësitë Financiare është një nga temat më të debatuar të projekt-ligjit për financat vendore nisur dhe nga situata aktuale në disa bashki të vendit. Sipas mendimit tonë, problemet për tu shtjelluar më tej janë kohëzgjatja e veprimit të Administratorit duhet përcaktuar sidomos lidhur me afatet e Kodit Zgjedhor për zgjedhjet lokale; kontributi i qeverisë qendrore që duhet përcaktuar; parashikimi i një dispozite tranzitore për situatën e gjetur nga kryetari i ri i sapozgjedhur pasi ai duhet të njihet me gjendjen financiare në të cilën do ta marrë njësinë e vetqeverisjes vendore etj.

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë vlerëson se **buxheti i miratuar** së fundmi për qeverisjen vendore për vitin **2017** nuk është koherent me ndryshimet në kuadrin e pushtetit vendor, me reformën administrative-territoriale dhe decentralizimin. Ky buxhet nuk përmbush nevojat tashmë të artikuluara të bashkive e sidomos nuk adreson situatën e hasur në disa



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

prej tyre për shkak të borxheve të trashëguara. Ligji për Buxhetin e vitit 2017 parashikon se buxheti për pushtetin vendor do të jetë në masën 3.1 % e PBB po aq sa ishte gjatë 2016, përkundrejt 2.8% të PBB për vitin 2015 (para reformës). Rritja me 0.3% nga viti 2015 në 2017 është një tregues jo domethënës në mbështetje të shërbimeve publike në nivel vendor krahasuar kjo dhe me kërkesën e Shoqatës së Bashkive që buxheti për 61 bashkitë e dala pas reformës duhet të arrijë në 5% e PBB për vitin pasardhës. Në paketën e Buxhetit për vitin 2017, në total Transferta e Pakushtëzuar rritet me 22% krahasuar me vitin 2016, edhe pse kjo rritje është për tu përshendetur, përsëri është një shifër e pamjaftueshme në raport me nevojat dhe shërbimet që bashkitë ofrojnë.

Cështje të tjera kanë qenë menaxhimi i situatës emergjente për shkak të kushteve të këqija të **motit**, strategjia e **decentralizimit**, kriteret për **strukturat akomoduese** etj.

III. Komunikimi me anëtarësinë

Komunikimi ka qenë tepër i mirë dhe efikas me të gjitha mjetet. Shoqata e Bashkive pasqyron aktivitetet, zhvillimet më të rëndësishme në fushën e qeverisjes vendore, si publikon njoftimet dhe aktivitetet në media sociale si Facebook, dhe në faqen e saj të internetit www.aam.org.al. Gjithashtu, dërgojmë paketa të materialeve të nevojshme për t'ju shpërndarë bashkive mbi legjislacionin vendor dhe të tjera.

Komunikimi me komunitetin e donatorëve brenda dhe jashtë vendit është në nivele të kënaqshme, në ndajmë me to të gjitha deklaratat, qëndrimet dhe opinionet mbi zhvillimin e pushtetit vendor, mbi padrejtësitë që anojnë nga bashkitë e djathta etj.

Marrëdhëniet me organizatat partnere dhe anëtare janë efektive, edhe pse duhet të kishte më shumë produktivitet, por arsye është fakti që ka një penalizim ngaqë shoqatat janë të ndara politikisht, dhe kjo frymë është më tepër tek partneret dhe donatorët në Shqipëri, ndërsa jashtë vendit jemi të mirë pozicionuar.

Marrdhënie shumë të mira kemi me NALAS (Rrjeti i Shoqatave të Autoriteteve Vendore në Europën Juglindore), i cili është një mbështetës dinjitoz për ne edhe pse në këto kushte. Me Nalas kemi 5 task forca ku marrim pjesë dhe përfaqësohen thuajse të gjitha bashkitë tuaja.

Me CMRE (Këshilli i Qyteteve dhe Rajoneve Europiane) nuk ka shumë marrëdhënie dhe aktivitet pasi Shoqata e Bashkive nuk ka paguar prej vitesh kuotën, por në bordin politik kemi përfaqësuesit tanë.

Me ALDA (Shoqata e Agjensive të Demokracisë Vendore), kemi bashkepunim të mirë dhe aktivite të pakta.



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Me Kongresin e Autoriteteve Lokale të Këshillit të Europës, jemi korrekt dhe aktivë politikisht me qëndrimet tona, po nuk kemi përfaqësimin që duam dhe kjo për arsye politike.

Shoqata ka përfaqësuesit e saj në çdo bord dhe agjensi apo komitete të përkohshme të projekteve si STAR 2, strategjinë e ujit, etj.

IV. Çështje për tu adresuar

Pa dashur të përsëris fjalët për klimën pozitive të ecurisë së punëve në Shoqatë, dëshiroj t'u paraqes disa shqetësime, me mendimin se do kemi mirëkuptimin dhe mbështetjen tuaj për të përmirësuar sa të jetë e mundur dhe me kontributin e të gjithë anëtarëve të Komitetit Drejtues. Këto çështje janë:

- Bashkëpunimi me Shoqatën për Autonomi Vendore dhe Shoqatën e Qarqeve;
- Këshilli Konsultativ Qeveri Qendrore –Qeveri Vendore.

V. Aktivitete për vitin 2017 (aneks)

Plani i aktiviteteve për vitin 2017 është bashkangjitur këtij raporti për diskutim dhe miratim nga Komiteti Drejtues.

VI. Raporti Financiar

Raporti Financiar për vitin 2016 dhe një raportim i të ardhurave të Shoqatës nga pagesat e kuotës së anëtarësisë janë bashkangjitur në këtë raport.

Faleminderit!

Agron Haxhimali
Drejtor Ekzekutiv